



## AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "UTS-01" SH.P.K.

Ne mbeshtetje te ligjit nr.7512, dt. 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire dhe privatizimit", te ligjit nr.7638, dt.19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit nr. 7667, dt. 28.01.2003 "Per rregjimin Tregtar" me vullnetin e tij te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e Aktit te Themelimit formohet:

### I. FORMIMI

#### 1.1 Formimi i Shoqerise.

Ortaku i Vetem i Shoqerise "UTS-01" SH.P.K. eshte:

Z. Markel BABALLEKU, i biri i Naunit, i dtl. 21.10.1977, lindur ne Berat dhe banues ne Tirane.

#### 1.2 Emri i Shoqerise

Shoqeria qe krijohet emertohet "UTS-01" SH.P.K.

#### 1.3 Qellimi dhe objekti i Shoqerise Tregtare do te jet e:

- Projektim te objekteve – civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri ne 5 kate.
- Projektim te objekteve – civile – industriale – turistike prej murature e skelet beton arme mbi 5 kate – objekte me skelet metalik.
- Projektim te objekteve me shkalle te larte veshtiresie beton arme – metalike – troje dhe shpate me qendrushmeri te ulet.
- Projektim rruge auto kategoria V dhe IV.
- Projektim ura dhe vepra arti deri 10 m.
- Zbatim te punimeve te germimeve te dheut me punime eventuale murature e beton arme prishje dhe punime ne toke te germuar.
- Zbatim te punimeve per ndertime – civile – industriale – turistike – bujqesore, deri ne 5 kate.
- Zbatim te punimeve per ndertime – civile – industriale – turistike – bujqesore, mbi 5 kate – Rikonstruksione.
- Zbatim te punimeve per ndertim rruge kategoria IV dhe V.
- Transporti i materialeve te ndertimit per vete dhe per te tretet, materialeve industriale dhe ushqimore, tregetimi me shumice dhe pakice i artikujve te ndryshem te ndertimit, industriale, ushqimore, prodhimeve bujqesore dhe blegtorale, duhane, pije alkoolike, aparatura elektrike dhe elektronike, lende te para per industrine e ndertimit e ushqimore.
- Import-Export, tregeti me shumice dhe pakice te materialeve dhe pajisjeve te ndertimit, industriale, ushqimore dhe veshmbathje.

Gjithashtu Shoqeria do te ushtroje veprimtari ne fushen e siper marrjes dhe sherbimeve ne fusha te ndryshme dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin.

#### 1.4 Selia

Selia e Shoqerise "UTS-01" SH.P.K. eshte ne: Rr."Pjeter Bogdani", pall. 20/4, shk. 3/3, Tirane – Shqiperi. Sipas vendimeve te miratuara ne Statutin e Shoqerise ajo mund te hape zyra, pefaqesi, filiale ne qytete te tjera te Shqiperise apo jashte saj.

#### 1.5 Afati i Shoqerise

"UTS-01" SH.P.K. do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat mbi 10 (dhjete) vjet. Si date e fillimit do te merret data e rregjistrimit te Shoqerise ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

## II. KAPITALI

### 2.1 Kontributet e Kapitalit

Sasia e kapitalit e derdhur sipas depozites se kesaj akt-marreveshje do te quhet kontribut kapitali themeltar.

### 2.2 Kapitali i Shoqerise

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 000 leke (njqind mije) qe perben kontributin e Ortakut te Vetem ne raport 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise "UTS-01" SH.P.K.

### 2.3 Financimi

Ne masen e duhur Shoqeria ka te drejte te siguroje financimin tregtar ose investues nga cdo Banke e Institucion financiar te huaj ose Shqiptar. Ky financim rregullohet me ane te kontratave te vecanta.

### 2.4 Llogaria e Shoqerise dhe ceshtjet financiare

Shoqeria "UTS-01" SH.P.K. i mban llogarite duke u mbeshtetur mbi bazen e lekut shqiptar si dhe tek valutat e qendrueshme. Shoqeria do te kete si vit fiskal vitin kalendarik.

## III . ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

### 3.1 Shoqeria "UTS-01" SH.P.K. ka keto Organe drejtuese:

- Asambleja qe eshte e perbere nga Ortaku i Vetem Z. Markel BABALLEKU;
- Administratori, njekohesisht Ortaku i Vetem Z. Markel BABALLEKU.

### DISPOZITA TE FUNDIT

Akti i Themelimit perpilohet ne gjuhen shqipe sot me date 11.01.2007.

ORTAKU I VETEM  
Markel BABALLEKU

*Markel Baballeku*  
*[Signature]*